



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|------------|----------------------|-------------------|
| Pranimi / Pranimja Me Datën 21-01-2025 | | | |
| Nr. Llogarit Org. Breg | Numri i... | Shprehje Vendosje | Vlera Vendnost |
| 01-060/01- | | | 14 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **30.01.2025 (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dymbëdhjetë e Kuvendit Komunal,
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin-plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit
5. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024.
6. Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024.
7. Informatë për zbatimin e planit të KKSB-së për vitin 2024.

Viti, më 22.01.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYMBËDHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 26.12.2024 (e enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Sokol Shaqiri, z.Sokol Hyseni, znj.Marigona Avdiu, z.Ali Bajrami, z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, znj.Zyrafete Rama, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, z.Taulant Haxhiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, OSBE-ja dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dymbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, përfaqësues të OSBE-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e dymbëdhjetë për këtë vit të kuvendit dhe njëashtu mbledhjen e fundit për këtë vit. Shfrytëzoj rastin të ju uroj festat e fundvitit të gjithëve dhe të ju uroj mirëseardhje mërgimtarëve. Gjatë kësaj periudhe shumica e akteve janë kthyer në përputhje me ligjin, por e kemi tek taksa, ngarkesa dhe gjoba. Prap me një ndryshim jemi në përmirësim që na u kërku në seancën e kalume me plotësu tek pjesa urbanizmit, prapë na ka kërku me bë një ndryshim. Para se me kalu në rend të ditës, hapi debatin për pyetjet dhe përgjigje, duke ju kërku që të ju përmbahemi kohës.

z.Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në emrin tim dhe emrin e këshilltarëve të LDK-së të ju dëshiroj të gjitha të mirat juve dhe familjeve të juaja dhe të gjithë qytetarëve të Vitisë, që viti 2025 të jetë vit i realizimit të suksesve dhe dëshirave tuaja personale. Pas certifikimit të lisatve për garë për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të gjithë kandidatëve të Vitisë të ju dëshiroj shëndet, suksese dhe të ketë një përfaqësim sa më nivel në zgjedhjet e 9 shkurtit dhe suksese.

z.Jakup Demiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në emër tim personal dhe grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ju uroj festat e fundvitit, posaqërisht dhe kolegut tonë asamblist Reshat Azizit festën e krishtëlindjeve. Mërgimtarëve një urim të posaqëm për këtë fundvit.

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë në emër të grupit parlamentar të PDK-së në Viti ju uroj festat për fundvit. Shfrytëzoj rastin t'i përshëndes edhe mërgimtarët dhe kam një kërkim falje për mërgimtarët që në këtë fundvit në Komunën e Vitisë kërkojmë falje për gjendjen.

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Urime festat e fundvitit! Kam një kërkesë nga lagjia “Demir Halabaku”. Me ditë të tëra kanë problem me energji elektrike. E dimë që edhe në vende tjera kanë këto probleme. Kërkojmë nga drejtori i shërbimeve publike, pasi që ka kontakte më shumë me KEDS, ta shikoj këtë mundësi, pasi që është problem i madhë me rrymë. Dhe tjetra, është shpall një vendim me 11.07.2019 për heqjen

e pousseve te shtrirë në rrugën "Haxhi Emini". Ne kemi bërë kërkesën si këshill i fshatit. Është edhe vendimi dhe me i hjek ato.

z.Basri Sylejmani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Rruga "Ibrahim Pira" në Pozheran, kërkesa e tyre është që nuk është shtru. Trotuari Sodovinë - Remnik i Ri a është në projekt apo nuk është? Kryesorja ka nevojë ajo rrugë për atë trotuar. Edhe për mbeturina më nuk kemi çka flasim, se ka në gjithë vendin. Unë po e shofë që njerëzit nuk janë të ndërjegjshëm, se dalim i hjekim, por prapë ata qesin.

z.Remzi Salihu: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Kësaj radhe kam 2 kërkesa. Deri ku ka ardh çështja e sanimit të kanalizimit në Remnik, tek një lagje aty? Kam qenë 2 herë në vendin e ngjarjes, jam konsultu, por veprime nuk janë marrë asnjëherë. Këtë e kam ngritë disa herë dhe kërka tjetë. Për Drejtorinë e Gjeodezisë. Drejtoreshë, a ka mundësi me na e spjegu se si qëndron puna tek nënshkrimi i kontratave për rregullimin e bartjen e pasurisë me shit blerje. Kam ankesa nga palët, se nga objekti i ri i komunës duhet të vij tek objekti i komunës së vjetër për një nënshkrim të vetëm.

z.Jakup Demiri: Pyetje për komunën, konkretisht nënkryetarin. Tek sheshi qytetit më nuk dihet ku përfundon po, në muajin qershor thojshin që përfundon, se kur të vjen mërgata, dhe tani ky pushimi dytë është në këtë gjendje dhe është bërë një kaos begi i madhë, se nuk dua me kalu bash pa e përmend, se është një kërkesë e qytetarëve dhe mos përfundimi. Tash a ka periudhë kohore për planin dinamik? Përfundimi i tij vetëm se ka kalu koha, dhe kjo paraqet edhe diçka për mospagesat e kompanisë në këtë rast apo si qëndron kjo. Pyetja tjetër ka të bëjë me disa trotuara nëpër fshatra, që kanë fillu mbi 4 vite. Kur priten të përfundojnë? Si në fshatin Smirë, Pozheran, por ka edhe lokalitete tjera që janë pa përfundu. Në sa projekte komuna i ka kryer obligimet, se sot jemi me 27, e dimë që me 24 përfundon afati i pagesave dhe a po i trashëgojmë obligimet financiare për vite të tjera, kur dihet se mos pagesa me kohë ka obligime financiare shtesë, duke filluar me 8% të kamatave për kryerjen e obligimeve në projekte të ndryshme.

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam rreth vendimit të kryetarit të komunës për anulimin e disa konkurseve nëpër dikastere të ndryshme, kur e dimë që diku janë kryer dhe afatet ligjore. Arsyeja se, në bazë të kompetencave kryetari i komunës shtynë deri me datën 09.02.2025, deri në përfundimin e fushatës zgjedhore, që do ta kemi me 9 shkurt 2025. Nuk është në rregull me luajt me ndjenjat e qytetarëve tanë të shtyhet deri në datën e zgjedhjeve, nuk di çfarë të themë. Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e shërbimeve publike dhe nënkryetarin. Meqenëse jemi të njohur për problemet që ka shkakto energjia elektrike këto ditë dhe bashkarisht me nënkryetarin kemi pas takim me zyrtarët e KEDS-it dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike për lagje të caktuara në qytetin e Komunës së Vitisë. Unë e di që në komuna nuk mundemi me prodhu rrymë, dhe vetë isha dëshmitar i asaj çka u diskutu me nënkryetarin, por nënkryetar dhe drejtor, ju kisha lutë që mos me na ardh kjo gjendje edhe vitin tjetër. Është mirë që presionin ndaj kompanisë KEDS ta adresojmë thujse çdo herë. Unë e pash vullnetin e nënkryetarit që nuk mungojke, po ne e kuptojmë që nënkryetari nuk na lëshon rrymën neve qytetarëve, por presionin me ngrit gjithëhere, meqenëse edhe pas takimit që kemi pas dhe pas takimeve tjera pas një proteste më radikale prapë gjendja nuk është e përmirësime, veç çka është më keq.

Znj.Majlinda Shabani: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Unë po kyqem në 2 çështje. E para me gjendjen aktuale ku jemi tu e pa që Komuna e Vitisë është duke u ballafaqu me ramje të dendura të borës dhe është tu shkakto vështirësi në qarkullimin e qytetarëve, por për ironi unë po e shof që kryetari i komunës është begi nshanë me kohë të fushatës dhe ka harru krejt që është kryetar komune. Po tenton me shfrytëzu këtë pozitë për fushatë të tijë, andaj unë kam parë që në disa lokacione ku janë viset rurale që unë vijë, prej fshatit Lubishtë, edhe sot pata problem me ardhë në seancë me kohë, për shkak që rruga nuk ke e pastrume. E njëjta vështirësi është dhe në fshatin Stubëll. Është mirë që kjo punë të merret me seriozitet, të pastrohet më shpesh, sepse e dimë që kompania është duke u pagu për me i kry këto shërbime, mirëpo duhet me pa dhe sa është duke e kry këtë punë. Çështja tjetër është për një shqetësim që e kam ngritë para disa muajve në seancë të Kuvendit komunal, ku ka të bëjë me banimin e përbalueshëm social, ku ka qenë thirrje prej ministrisë, investim prej nivelit qendror, ku thirrja e parë ka qenë në muajin shkurt dhe unë kam ngrit si temë ku kam thanë që, Komuna e Vitisë është mirë me shfrytëzu këtë mundësi me apliku, që qytetarët e Komunës së Vitisë me përfitu në këtë mundësi. Komuna e Vitisë as nuk ka qenë fare e interesuar që fillimisht me nda lokacionin për këtë investim ku kemi bërë.

raport dhe reagime ne si Lëvizje Vetëvedosje që të paktën me mundësu që me apliku në thirrjen e dytë, dhe prapë Komuna e Vitisë ka hezitu për me apliku. Kanë qenë 13 komuna që kanë qenë përfituese, dhe në anën tjetër kemi një kryetar komune që vazhdimisht bënë kritika për investime që bëhen nga niveli qëndror, dhe në momentin që vijnë mundësitë për investimet të cilat financohen nga nivelin qëndror, ai e injoron këtë çështje dhe nuk merret fare me këtë temë. Unë kërkoj përgjegjësi se, pse nuk kanë apliku në këtë mundësi, në këtë investim që ka qenë shumë i rëndësishëm për qyteaterët e Komunës së Vitisë.

z.Sokol Shaqiri: Përshendejte për të gjithë të pransihmit! Kam një pyetje rreth oborrit të shkollës së fshatit Tërpezë, sepse kur ka reshje fëmijët, nxënësit, veturat nuk mujnë të parkohen siç duhet. Duhet me reagu urgjentisht me rregullu këtë çështje.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pransihmit! Për ndërtimin e trotuareve në Komunën e Vitisë, gati se në shumë seanca kam potencu se, trotuari i cili lidhë fshatarat Sllatinë e Epërme, Trestnik nuk është përfundu me datën 27.10.2021, është lidhur kontrata në vlerë prej 820 mijë e 153.13 euro. Afati i kontratës ka qenë 2 vite prej 27.10.2021 deri me 27.10.2023. Në kuadër të kësaj kontrate kanë qenë të përfshira shumë trotuare nëpër fshatra të Komunës së Vitisë, por pjesë e kësaj kontrate ka qenë i përfshim edhe trotuari i cili e përfshin Sllatinin me Trestenikun me gjatësi prej 2746 metrave gjerësi 1.2 metrave. Vlera ka qenë 84 mijë e 153.84 euro. Deri më tani ky projekt është realizu vetëm përafërsisht 50%, mirëpo pjesa tjetër ka mbetë pa u realizu. Dua ta dijë kur do të përfundoj ky trotuar, se është tejzgjatur. Në seancën e mëhershme kemi bërë pyetje, por nuk janë kthyer në seancë dhe nuk janë kthyer me shkrim, dhe pyetje tjetër është për ujin e pijes. Shumë lokalitete kanë mungesë të ujit të pijes, ngase ky problem nuk është zgjidhur, edhe pse nëpër fushata në të gjitha takimet është potencu se, prioritet i strukturave komunale do të jetë uji i pijës. Po e potencoj rastin e 5 fshatrave, po e potencoj që nuk ka ujë, por nuk është uji i pijes, uji përdoret vetëm për larje, pasrtrim. Shtrohet pyetja: çfarë mund të bëjnë strukturat komunale në këtë drejtim, që qytetarët të kenë ujë të pijshëm? Sepse, shumica e qytetarëve janë të obliguara me u furnizu në vende të tjera me ujë të pijshëm ose të hapin puse të cilat kushtojnë. Kam një pyetje rreth rregullimit të rrugëve. Në këtë drejtim Komuna e Vitisë nuk është që nuk ka rregullu rrugë, por shumica e rrugëve, kualiteti i tyre është nën nivelin e dëshiruar. Deri tash ka rrugë që nuk është bërë pranimi teknik i këtyre rrugëve. Po potencoj rrugën Sllatinë - Viti, rrugën "Beqir Kurti" në fshatin Trestenik, që tash po të shkohet të shihet ajo rrugë është kthyer prej asfaltit në zhavorr, dhe shumë rrugë të tjera. A mund të dilni ju si struktura komunale, t'i vizitoni këto rrugë, t'i shini dhe t'i riparoni.

znj.Liridona Bislimi: Përshendejte për të gjithë të pransihmit! Urime festat e fundvitit. Kam një pyetje sa i përket fushave sportive që janë shtruar me goma. Nën kryetar kemi ankesa, ku pjesa dërmuese e këtyre punimeve që janë bërë ose janë shtruar për herë të dytë ose veç se janë të dëmtume në masë të madhe. Më intereson me ditë se, ka shqetësime prej prindërve, meqenëse ajo pjesë shfrytëzohet prej fëmijëve. Dua ta di pse ka ndodhë ky problem, a është problemi tek punëkryersi apo te materiali që është përdor. A jeni mirë me këtë çështje? Kërkesa tjetër lidhet me banorët e rrugës "Hebib Sejdiu" këtu në qytet. Ata kërkojnë që me u vendos pengesa rrugore në atë pjesë, për shkak që ndjehen të rrezikuar nga veturat. Nga takimet që kam mbajtur me banorët, ata kanë konfirmuar që kanë pas raste të freskëta, por edhe të mahershme, ku fëmijët janë lënduar nga vozitësit e pakujdesshëm, andaj konsideroj që në mënyrë urgjente duhet të veproni karshi kësaj kërkesë.

z.Illir Zuka: Kemi një problem ne Pozherani. Para disa muajve kemi intervenu, kemi rregullu rrugën e qendrës. Kush i bie nëpër Pozheran besoni që është bërë e pakalueshme, por çka është shqetësimi më i madhë, para 1 muaji është asfaltu rruga prej Kllokotit e te dalja Radivojcit: a ka komision që e mbikëqyr atë? Se krejt asfalti ish dëmtu. E di që është e nivelit qëndror, por aty po kalojnë banorët e Komunës së Vitisë. Pyetja tjetër është që, para 1 viti kemi nda një pronë të Komunës së Vitisë për ndërtimin e një çerdhe. Çka ka ndodhë me atë pronë.

z.Sejdi Emini: Përshendejte për të gjithë të pranishmit! Urime festat e fundvitit! Kam një kërkesë për pushimoren e autobusit në Gërmovë, te rruga për Goshicë. Është vend që posa është rregullu është ngrit mbi mesatare dhe makinat me dashtë me i marrë qytetarët që presin nuk munden. Është mirë me sanu atë problem. Dhe rruga për Goshicë, ajo hapësira që ka mbetë mes trotuarit dhe asfaltit, d.m.th dhe punët të cilat janë tu rregullu janë tu prishë për shkak të ujit që ka fillu me i demtu. Kam pas një kërkesë nga fshati ku kemi kërku

...isa barriera ne rrugë shkaku i shpejtësisë së makinave aty 4 kanë ardhë, por kërkesa ka qenë për 6. Tek rruga "Bajrami", aty nuk e kanë bërë, disi i ka ra sikurse nuk është dashtë me bë, aty është dashtë me bë për të gjithë, sepse është bërë e pa drejtë. Një problem serioz është tek mirëmbajtja, tek fusha në Sodovinë dhe Pozheran, është një investim që është afër gjysmë milion. Dhe në çfarë gjendje ka ardhë, nuk e di në 2-3 vite a ka me ekzistuar apo jo. Është mirë që në vitin që vijmë me caktuar një mirëmbajtës, përndryshe kotë investojmë, puna duhet me u mirëmbajtur.

z.Ali Bajrami: Drejtoresha e shëndetësisë është mirë me dhanë një sqarim për qytetarët e Komunës së Vitisë, sa i përket furnizimit me vaksina kundër gripit. A ka pas sasi të mjaftueshme në QKMF dhe AMF, dhe a është i mbuluar territori i Komunës së Vitisë me nevojat që i kanë qytetarët sa i përket vaksinave. Pyetja tjetër është që, kur i shfletova pasqyrat financiare janar-shtator, hasa aty në numrin rendor 24, ka të bëjë me rrugën Sodovinë e Jerlive, "Lagjia e Muhaxhirëve" në Goshicë. Pse ka mbetë ajo rrugë ende pa u asfaltuar?

z.Basri Aliu, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Urime festat e fundvitit! Dua ta falenderoj dhe një bashkatdhetar tonin, i cili ka sjellë një donacion me një vlerë shumë të konsiderueshme, 4 automjete, 2 kamiona të zjarrfikësve, një kombi dhe një automobil. 3 kanë ardhë, një e kemi në dogan. Ai është Vilson Gega nga Binça së bashku me vëllaun e tij Roberitin që jam mirënjohës dhe i përkulem për veprimin të cilin e kanë bërë për qytetarët e Komunës së Vitisë. Për tek mbeturinat, fakt është, mbeturinat që nëpër fshatra dhe oborre i kemi largu, po kemi fillu ti hedhim në natyrë. Ne po mundohemi, po i largojmë, por prapë qyteatërt e pandërgjegjshëm po shkojnë po i perserisin ato. Është mirë me bë një apel të gjithë që ata të inkuadrohen në "Ekohigjien" dhe mos ti hudhin mbeturinat nëpër rrugë. Remziu e përmendi kanalizimin në fshatin Remnik, po ka hy në projekt, sigurisht që ata do të ndërveojnë ndërkohë, sepse nuk është në mirëmbajtje të shërbimeve publike, por pasi ka qenë një gjatësi koggio e madhe e defemitimit të atij kanalizimi, është në projekt që me projektin e kanalizimeve të rregullohet dhe ajo. Për energjin elektrike pat një apel nga asamblesiti që t'i bëjmë presion. Ne çdoherë i bëjmë preison dhe çdo qytetar që bjen një kërkesë ne i drejtohem me shkrim, sepse forma tjera nuk kemi. Pastrimi i rrugëve Lubishtë është e 3-ta herë që kompania ishte sot atje dhe rruga është shumë e kalushme deri aty ku e kemi të caktuar, rrugët e caktuar. Është mirë që edhe tjerat me u përfshi, por për shkak mundësive që nuk i kemi, d.m.th rruga në Lubishtë është e kalushme, sepse vet kam qenë prezent aty. Pat për vendosjen e barrierave, por patë një kërkesë për heqje të barrierave. Mirë është me ju drejtu Drejtorisë së Inspeksionit kërkesa, në mënyrë që ata ta vlerësojnë, sepse është një ligj i cili i përcakton ku mundet me i qitë barrierat. Sa për prietoren në Gërmovë, do të shofim të ndërveojmë, edhe pse ajo është në kuadër të ministrisë, nuk është në kuadër tonë, po nuk do të thotë që nuk do të interesohemi për këtë.

Ilir Zuka: Drejtor, ne e kemi pas kërkesën kur e kemi vendos. Po tani pas një muaje me kërkesen e banorëve është marr vendim që kërkesa e jonë nuk ka qenë e ligjshme dhe e kemi marr një vendim që ta dërgova me 11.07.20219 për heqjen e pengesave, po për shkak që ka pas një konflikt ndërmjet banorëve që a mu hek apo jo ka mbet nje polic i shtrirë aty, e nëse komuna nuk e hek kanë me dal banorët me e hekë, e prej frikës që mos mu përsëritë i njëjti incident si ka qenë në vitin 2019, kërkoj prej institucioneve komunale që, me dal me hekë atë pengesë. Është tek rruga "Haxhi Emini".

z.Basri Aliu, drejtori: Ilir, në momentin e parë që del kompania do të heqim atë polic të shtrirë, sepse te koka kërkesë e qytetarëve.

znj.Merrushe Ahmeti, drejtoreshë: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pyetjes së z.Aliut, rreth vaksinave në Komunën e Vitisë, atëhere më lejoni të ju njoftoj që, vaksina kemi të mjaftueshme për të gjithë banorët e Komunës së Vitisë. Nëse ju referohemi me vitin e kaluar, kanë qenë 2800, ndërsa këtë vit i kemi 3500 dhe se vitin e kaluar me 2500 kemi arritë me i mbulu, ndërsa këtë vit kemi akoma me shumë, që do me thanë që, mbesin. Mirëpo për çdo rast ato janë në frigorifera, ndërsa marrja e vaksinave bëhet në QKMF në Viti, për shkak të kushteve, sepse vaksina i ka disa kushte specifike ku ajo duhet me qëndru për shkak të logjistikes. Ajo jepet në QKMF në Viti. Po ashtu i ftoj të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë që të marrin vaksinat për imunitet të gripeve. Le të vijmë me i marr nga ora 08:00 deri në ora 15:00. Pasi që është fundi i vitit, po du me ju uru për bashkëpunimin e bërë.

znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Pajtohem me pyetjen e asambleistit. Po, pagesat në kadastër kryhet deri në 10 euro, ndërsa pagesat mbi 10 euro, fletpagesat merren tek Drejtoria e Financave. Nuk është kompotencë e imja, është organizimi i brendsëhm i Drejtorisë së Financave.

z.Remzi Salihu: Faleminderit drejtoreshë për përgjigjen e dhanë! Atëhere pasi që nuk është kompotencë e juaj, unë kërkoj nga zyra kompetente të na njoftoj pse është bërë kjo, për çfarë arsye, sepse po enët pala pa arsye.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Në fillim do të ju dëshiroj të gjitha të mirat mërgimtarëve të cilët e kanë gjallëru Vitinë e Kosovën, sepse këta janë shtylla e vendit tonë. Ju falenderoj për kontributin e dhanë për këtë vit. Po ju përgjigjem pyetjeve. Rruga "Ibrahim Pira" besoj që nuk ka pas qëllime të këqija kjo rrugë, po me siguri në mungesë të buxhetit nuk është shtrur. Besoj që do t'i vijen radha edhe saj. Trotuari Sadovinë - Remnik i Ri. Ne kemi pas një kontratë dyvjeçare të cilën nuk e ka kry ai dhe nuk e ka përmbush kontratën të cilën e ka pas, dhe tani janë dhënë punët kompanisë tjetër. Po bash detalisht tash nuk e di si kanë shku punët. Pagesa tek Kadastru ka qenë një referat të cilin me siguri nuk e ka parapa kryetari me burimet njerëzore, dhe qat referat ja kanë bartë arkatarit. Kështu që, ndoshta duhet me bërë zgjidhje që mos mi maltretu palët dhe besoj që kemi me bërë zgjidhje që mos me kriju vakum dikun duhet mu kry. Arkatari nuk mundet me shku atje, sepse është në kuadër të Drejtorisë së Financave. Po besoj që do t'i bëhet zgjidhje edhe kësaj. Sheshi nuk është përfunduar, përkundër trysnisë që sidomos mujin e fundit ka bërë edhe vet personalisht mu ka pas zotë që do ta përfundojnë deri me 15 dhjetor, nuk është bërë as deri me 25. E kështu që, tash ndoshta këto ditët e fundit edhe kushtet atmosferike e kanë penguar, po nuk është arsye kjo, sepse ka pas kohë me e përfunduar kompania. Pat pyetje, sa projekte nuk ju ka kry pagesa. Nuk e di këtë, nuk kam informacion. Unë besoj që në seancën e janarit do të ju njoftoj. Çështja e energjisë elektrike. Presioni Musë. Unë të falenderoj që ke pas atë ditë mirëkuptimin që me ardh në takim, nuk ka përfunduar atë ditë. Unë për çdo ditë po bëjë presion të vazhdueshëm brenda mundësive që i kemi. Unë pra do të kërkoj me u rregullu gjendja e energjisë elektrike në lagjet e komunës sonë. Çështja e konkurseve. Është e drejtë e ekzekutivit, është e drejtë e kryetarit. Kryetari i ka disa zyre, përveç drejtorive që i ka i ka edhe disa zyre të cilët unë konsideroj që konsultohet, dhe ka marr një vendim të tillë. Tash a është vendim politik apo jo, unë konsideroj që më mirë i shërben ndoshta se me pas vendos kishit than e ka për vota, mos me pas vendos, po thoni e ka për vota. Unë besoj që krej këto ndoshta në kohën e fushatës është më e mirë mos me pas, megjithatë ajo është kompotencë e kryetarit, këtë duhet me dit. Samiu e ka pas bërë fillimish një kërkesë për te banimi social. Ata kanë kërku edhe dokumente tjera. E mund të ndodh që, inxhinierat nuk i ka qu. Unë konsideroj që të kapni shumë në këtë projekt, se nuk është ku me ditë çfarë projekti ai. Ku është ajo e mirë ne mu hek prej gjendjes sociale, se nuk është e mirë. Megjithatë edhe unë po pajtohem që mund të ndodh që nuk i kanë qu. Oborri në shkollën e Terpezës nuk e besoj që është në qat gjendje. Po do të ja përcjelli drejtoreshës. Pyetjen, uji i pijes. Sipas një komisioni që e ka caktuar kryetari, së bashku me "Hidromoraven" në pengesa të cilat i ka ujësjellësi për pesë lokalitetet. Ata e kanë bërë një paramas dhe parallogari, të cilën nuk kemi pas mjete të parapamë që dikun kap shumë mbi 80 mijë euro, që duhet të intervenohet për me e marrë në menagjim të plotë "Hidromorava". Kualitetit i rrugëve jashtë kualitetit. Besoj që komisionet që formohen për pranim teknik, ata e kanë fjalën e fundit. Fushat sportive. E di që nja e kemi bërë për së dyti, për shkak të kualitetit e për tjerat unë besoj që ato që janë pranë, komisioni e ka përgjegjësinë. Çerdhja, prona është aty, besoj që e kanë pajisë edhe me leje ndërtime, e kur fillon ajo nuk e di. Kemi fillu me i eliminu këto hapësirat ndërmejt rrugëve. Tek mirëmbajtja e fushave në Sadovinë dhe Pozharan. Me sa e di unë në Sadovinë është një i caktuar për me e mirëmbajt fushën në Pozharan. E di që u ngritë shqetësimi për këtë.

z.Illir Zuka: Nënkryetar, e di që nuk është kompotencë e nivelit komunal, po me një kërkesë pjesa e qendrës në Pozharan tu fillu nga "Viva" deri tek rruga e Vitisë, kam pengesa nga shumë biznese, është problem parkingu, është dëmtu rruga shumë, tash është bërë problem për vetura, sepse është dëmtu shumë asfalti.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Illir, do ta ngrisim këtë shqetësim. Pse jo edhe me i dërgu kërkesë ministrisë.

znj.Majlinda Shabani: Tek tema e banimit të përballueshëm social, sepse për mu ke shumë shqetësuese mënyra se si nënkryetari mu përgjigj. Dhe me sa e pash, nënkryetari as që ka njohuri dhe as dijeni se për çfarë projekti bëhet fjalë, dhe në moment kur ti thu se si është mundësi që ne me e eliminu këtë kategori të njerëzve

te cilet jane me social, d.m.th ti nuk ju ofron as ndihmën e parë që ju duhet. Sa për dijeni, tek projekti i banimit të përballueshëm social, këtu kishin pas mundësi me përfitu jo vetëm nje kategori po shumë kategori. Tu i përfshi edhe familjet të cilat kanë vështirësi ekonomike. Viktimat me dhunë e shumë kategori tjetra, dhe përpos kësaj, ka qenë edhe mundësia tjetër ku ka qenë i përfshirë edhe projekti për rindërtim dhe ndërtim për shtëpitë private, pikërisht për ato familje të cilat kanë vështirësi me kushtet elementare të jetes, dhe prandaj kjo është shumë shqetësuese se si Komuna e Vitisë mundohet me neglizhu komplet këtë kategori të njerëzve, kur e dimë që është nevoja shumë e madhe që dora e komunës dhe e shtetit me u ndje pikërisht në këtë kohë, dhe unë e marrë përgjigjen që, zyrtari e paska dërgu një projekt dhe këtu po e shof se sa interes keni ju si komunë që familje të cilat janë në gjendje të rëndë sociale me i nxjerrë prej asaj situatë. Kjo është shumë shqetësuese. Tek pyetja e dytë, ke tek pastrimi apo mirëmbajtja e rrugëve në viset rurale. Unë e kam përpara kontratën e cila është e nënshkrume për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Vitisë për dy vite, 2024-2026, ku Komuna e Vitisë i shpenzon dikun 200 mijë euro. Pikërisht për këtë kontratë dhe unë pyetjen e parë e kam se sa kilometra. Se këtu janë të theksume 1200 kilometra. Në sa kilometra bëhet pastrimi i rrugëve? Dhe tjetra pyetje. Unë nuk e di se si po mundeni me e arsyetu veten. E di domos në këtë situatë, sepse ne e dimë që borë nuk bie në 12 muaj të vitit. Është situata emergjente, duhet me qitë tek intervenimi emegjent dhe duhet me i pas parasysh lokalitetet të cilat janë në viset rurale dhe kudrinore. Nuk mundet me shku njëhere në fshetin Lubishtë, Stubëll, Beguncë me pastu borën dhe me thanë e kemi pastru, dhe po flet që nuk kanë qenë mundësitë mi pastru. Tek fshati Lubishtë, tek pjesa e qeshmës, nëse jeni në dijeni, është rruga më e vështirë që qytetarët kanë pengesë me e tejkalu qat situatë, dhe këtu ju jeni tu shpenzu mira e miliona euro për pastrim të rrugëve, dhe ne anën tjetër nuk kryhet. Puna, puna nuk është tu kry. Paret janë tu shpenzu puna sa tu kry. Mirëmbajtjen e rrugëve verore nuk kemi kërkun, e as mirëmbajtje të rruge dimërore nuk kemi kërkund. Kjo çka po i bjen, e jemi në mëshirën e fatit. Të lutem që, mos të bie shumë borë që të mbesim të bllokuar.

z.Basri Aliu, drejtor: Këshilltare, tu kisha lutë që mos dezinformo para qytetarëve, se unë që ku e kam fotografinë e fshatit Lubishtë. Unë po të thamë që kam qenë në ora 9 aty tri here, kemi informu nga ditë që ka ra borë. Unë po të flas që deri te shkolla rruga është e qelt e për pjesët lagjore nuk e di, sepse nuk muj të gjitha me i hap. Edhe sa e vërtet atë që e thave ti që, nuk janë mirëmbajt verës rrugët pikërisht në Lubisht kemi intervenu edhe verës. Sun gjenë asnjë komunë që i ka rrugët me të mirëmbajtura se Komuna e Vitisë. Tani hajde fol me mu. Prandaj nuk duhet ta keqpërdorni foltoren dhe ti thuani ato të pavërteta.

z.Musli Neziri: Drejtor, për pyetjen KEDS-it, unë ju falenderova të dyve për angazhimin, mirëpo problem është me bë ende presion tek ata që me e rregullu, mos me e lanë në harresë, sepse vetëm çka po keqsohet gjendja. E tek pyetja e dytë nënkryetar, tek pjesa e anulimit të konkurseve. Ju e thatë që e ka shfrytëzu kompetencen ligjore kryetari, po komponecen ne aryje te vendimit e ka qit infiltrim për shkak të zgjedhjeve. Tashti kush do që e lexon qat arsyetim e sheh se a më shumë ka infiltrim pas qeti vendimi apo para vendimit. Tjetra është se, kompetencë për rekrutimin e personave që kandidojnë. Ne e dimë që është e zyrtarëve të personelit, të Njësisë për Burime Njerëzore. Ne shpesh kemi marr përgjigje prej personave adekuat, qoftë prej ingjinerave të komunave apo personave konkret, e në këtë rast këtu e kemi shefin e personelit të burimeve njerëzore për nga aspekti ligjor. Se a ka pas shkelje apo nuk ka pas, ai ndoshta munet të na thotë më shumë, sepse në arsye po thotë infiltrim. Duhet me ditë pse po anulohet. Po unë e kërkoj një sqarim prej shefit për burime njerëzore.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë po besoj se vendimin e kryetarit të kuvendit nuk ka nevojë me e diskutu, se nuk e ka prek kuvendin. Është e drejtë ligjore e tij a ka gabu a jo. Janë instanca tjetra që e vlerësojnë, po s'a problematike që mu diskutu në kuvend. Majlindë, unë të tregova shumë kjart, ama ti po ki qef që unë me fol qysh ti ki qef. Po nuk flas unë, po nëse ty po të dhem shumë ai projekt, ki shumë projekte tjera, shty përpara. Nuk e ke ngritë çështjen e çerdhes kurrë, e çështje tjera.

z.Hysen Ymeri, udhëheqës i burimeve njerëzore: Njësia për Menaxhimin e Personelit është njësia e vetme para institucioneve komunale e cila banë, përcjell me autorizime e kompetenca ligjore procedurat e rekrutimit. Njësia ka pranuar kërkesën prej Drejtorisë së Administratës Publike, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Arsimit. Ne kemi zhvillu procedurat konform ligjit. Asnjë pengesë nuk kemi tek shërbimi civil, deri në kryerjen e procedurave me shkrim. Në momentin kur procedura ka fillu për kandidatin fitues, kandidati i cili ka

kalu fazën e testit me shkrim, atëhere u dashtë të zhvillohet procedura tjetër e kandidatit, që ka qenë një. Njëri ka fitu, të tjerët kanë ra. Ne kemi marr informacione se, kryetari i komunës, z.Sokol Haliti ka nxjerr një vendim me të cilin thotë anulohet procesi i rekrutimit. Mu si jurist nuk më takon ndoshta mu përzi në kompetencat e kryetarit të komunës. Është çështje e tij. Më takon me thanë diçka publikisht. Është për keqardhje vendimi të cilin ja kanë servu ata 11 juristat e famshëm që rrinë aty në atë zyrën. Është për keqardhje. Sipas Ligjit për Procedurën Administrative thotë, akti nënligjor duhet të ketë formë dhe përmbajtje për formën. Nuk kemi se çka me folë, është katastrofike për përmbajtjen. Thotë vendimi: anulohet konkursi publik për zyrtarët e gjendje civile. Fjala është për një ofiqar dhe anulohet konkursi për punëtorët teknik. Ku keni pa bre, këta të dytë nuk rregullohen me një ligj. Ky ka të bëjë me Ligjin për Shërbimin Civil, që e ka një rrugë tjetër. E ky tjetri ka të bëjë me Ligjin për Zyrtarët Publik, stafin mbështetës dhe administrativ. Një afat ligjor tjetër, aq më keq thotë anulohet konkursi publik dhe shtyhet deri me datën 09.02.2025. Po juristi ndoshta nuk po di, po kur një vendim anulohet, nuk shkohet tutje, ndalet. Jo deri me datën 09, po anulohet, shkojmë nga fillimi. Çështja tjetër që thotë me anulu për shkak të infiltrimit. Hajde, le të me kallëzon mu dikush çka do me thanë fjala infiltrim. Infiltrim i armikut të brendshëm, të jashtëm. Kush ka hi aty? Nëse ka indikacione që po keqperdoret porcedura ose ka ndonjë provë e mirë, që qonë deri tek anulimi i një veprimi, atëhere le ta cakton këtu. E keqja e kësaj hala me tutje thotë, këshilla juridike thotë po. Po pajtohem, akti administrativ ka hyrje dispozitive. Arsyetim dhe këshill juridike. Pala gjithsesi duhet të orientohet se ku duhet të ankohet. Për të dy vendimet thotë: pala e pa kënaqur në afat prej 30 dite ka të drejtë në komisionin e ankesave për zyrtar publik. Jo, nuk është qështu. Komisioni i ankesave për zyrtarët publik ka të drejtë ankese për zyrtarët publik në shëndetësi dhe në arsim e jo për shërbyesit civil. Për shërbyesit civil shkon dikun tjetër. Direkt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, atje. D.m.th janë procedura të ndame, e këtu nuk i ki procedurat e ndame. Tash ky zotnia që është fitues, që i ka dal emri aty jo kundërligjshëm, po në baza ligjore, ama shumë ligjore, dhe nëse ka diçka antiligjore unë e ftoj prokurorinë publike të Republikës së Kosovës, që le të vjen këtu dhe të heton rastin fund e kry. Mu le të më heton, por edhe te tjerët për veprimet eventuale të shkeljeve ligjore, që nuk ka. Prandaj ky është një akt që jo një jurist, po një njeri me i thjeshtë nuk do të kishe bë këtë. Po me vjen keq që kryetari ka ra në lajthim, po me doket mu që ka ra në lajthim. Rasti tjetër është, vendimi për anulimin e konkursit tek shëndetësia. 7 intelektual kanë konkuru aty, 7 mjekë. Kërkesa e drejtoreshës ka qenë me rregull këtu, ndërsa kërkesa e Vjollca Kadollit, drejtoreshës së QKMF-së thotë, nëse ka mundësi edhe ligjin me shkel vetëm më shpejt se nuk ka kujdestari. Marrë unë edhe i qes, e vjen vendimi edhe obligohet Njësia e Personelit me e ndal procedurën, edhe thotë kështu, e citon Ligjin për Procedurën Administrative. Ku ka bre citim në arsyetim. Qysh shkruhet në arsyetim citoj. Po nuk shkruhet, nuk ka akt administrativ. E thashë më parë, i cili që nuk e ka këshillën juridike akti administrativ pa këshill juridike është zero. Le të del cili do jurist këtu le të më thotë që sa qashtu, ndërsa qe ku e keni vendimin pa këshillë juridike. Ku duhet me shku këta. E keqja e krejt kësaj është se, gabimish është nxjerrë vendimi i kundërligjshëm. Është ndërhyrje në procesin e rekrutimit, me të cilin është e autorizuar Njësia e Personelit. Nuk është kryetari i komunës. Aq më keq që këtu nuk është vetëm një ligj, këtu kanë të drejta dhe autorizime edhe ligje tjetra, Ligji për Zyrtarët Publik, Ligji mbi Pagat edhe ligjet e tjera. Tash edhe Ligji për Procedurat Penale, Kodi i Procedurës Penale parasheh sanksione. Sanksione që nuk janë të lehta. Nëse ato shkojnë ka kryetari i komunës, neni 218, 2019, 2020, zotëri nënkryetar e implikon keq kryetarin e komunës për veprimet të cilat i ka marr. Nuk ka të drejtë askush të ja mohoj dikujt punësimin, dhe nuk ka të drejtë askush të ndërhyjë te komisioni, nuk ka të drejtë në vendimmarrje, aq më keq nëse është zyrtar i lartë, në kete rast kryetari i komunës ose nënkryetari. Dënimet janë të precizume, minimumi 2 vite, maksimumi 5 vite. Prandaj Zyra e Personelit nuk është konsultu për këto veprime, mu nuk më ka konsultu askush, po vetëm më obligon, ku thotë: obligohet Njësia për Menaxhimin e Personelit t'i ndërprën procedurat. Unë nuk e kam ndërpre, tek shërbimi civil kandidati është fitus, atij i ka dal emri dhe këtu përfundoj punët. Tek këta tjetrt janë ndal për arsye se i është dhënë urdhër arkives që mos me i pranu dokumentet, prandaj veprimet të qojnë në inkriminim, keq. Unë i kam kry punët e mijja dhe për mu si Njësi për Burime Njerëzore këto veprime janë antiligjore, dhe për këtë që po e tham mbaj përgjegjësi penale, dhe nëse unë kam shkel që e kam qit emrin e kandidatit fitues, e apeloj kryetarin e komunës, nënkryetarin dhe qytetarët tjerë, urdhëroni qone lëndën në prokurori publike, atëhere e shohim se kush ka gabu, kush e ka shkel ligjin.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Kurr nuk kisha dëshirë këto çështje me i bisedu në kuvend, por ajo që muj me plotësu, me u pajtu vetëm fjala kur thot se, pas intervistimit me shkrim, më ka ardh vendimi. Kjo është e sakt, ndërsa tjerat nuk duhet me i impliku njerëzit, se sikur ti që je zyre e kryetarit, edhe nuk ban me i nënqmu të tjerët. Kryetari e ka një zyre ligjore të cilën kur e ka marr pushtetin e ka gjetë aty në zyre ligjore, dhe tjetrën të cilën e keni rekrutu para një viti, që kurrë profesionalizmin e tyre nuk kam të drejtë me ja kontestu, se ja kontestojnë ata të cilët ja kanë dhanë diplomën. Qat vendim nuk e ka pru kërkush tjetër. Është një e vërtet që, kryetari ka mujt me i thanë shkoni në përputhje me ligjin. E kanë pru dy zyrtarë të cilët punojnë në Zyrën Ligjore, e jo 11 jurista, se gjithsecili e ka pozicionin e vet, prandaj të drejtën me i thanë nuk ki, se edhe kryetari i ban përgjegjësitë e veta. Edhe në rast se ti je kanë konform saj, hiç nuk e ke pas problem, se krejt objektet jan dikun 100 metra largësi me ardh me i thanë: kryetar, kur e ke marr vendimin mi thanë, kryetar, këtë që e paske ba e ki në kundërshtim. E ki edhe obligim, sepse je zyre e kryetarit të komunës, edhe ke mujt me e sqaru e nuk ka nevojë me i debatu në kuvend, se je ekzekutiv. Kryetari është organi me i lartë administrativ që i bjen, ti je zyre e tij, e kryetarit. Tash ajo simpatia see a do a jo, nuk me banë përshtypje. Në aspektin hierarkik je obligativ me shku me i thanë, e unë se di që i keni bisedu këto. E pse nuk i keni bisedu këto, është çështja e juve dhe e atij. Kryetari u konsultu me Zyrën Ligjore kur e ka bë këtë vendim. A e ka mirë apo se ka, ndjekne rrugën ligjore, ka shkallshmëri të vendimit.

z.Hysen Ymeri, udhëheqës i burimeve njerëzore: A e din çka është keq nënkryetar, këtu kur ju vet e pranoni dhe e dini sakt që, këto janë veprime që nuk jan ligjore, që nuk janë të bazuara në ligj. Thua në ti ndjek rrugët ligjore. Unë po pajtohem saktësisht se ka shkallshmëri. Të lutem, banju të fala atyre që e kanë nënshkru këtë, jepja shkallshmërinë aktit administrativ, orientohe, se ku me shku palët e pakënaqura. Unë jam obligativ mos me i zbatu vendimet kundërligjore, sepse Ligji për Zyrtarë Publik, tekstivish e thotë: nëse zyrtari e sheh se urdhëri i kryetarit, nënkryetarit është i kundërligjshëm. Unë nuk e zbatoj. Ndërhyrja në procedurën e rekrutimit dhe vendimet të cilat i ka sjellë kryetari i komunës, fatkeqësisht kush e ka këshillu, nuk e di, është shkelje ligjore dhe nuk është e zbatueshme, mbaj përgjegjësi penale. Prandaj unë, këtu thotç: obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore ta anuloj këtë. Nuk e anuluj, sepse nuk mbaj përgjegjësi, e ju shkoni ndalne arkiven atje, jepni urdhëra, po unë nuk e anuluj. Nëse ka dikush kushdo, urdhëroni, shkoni në prokurori publike edhe bane kallzim penal kundër Hysen Ymerit.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i kuvendit: Unë mendoj që çdo pyetje e kuvendit që orientohet nga ekzekutivi, pa marr parasysh çfarë sektori është, e kanë për obligim me na dhanë përgjigje, me na dhanë informatë.

znj.Majlinda Shabani: Unë realisht nuk po e kuptoj më së pari këtë tendencën me u mundu me naj nal fjalën. Mu përmend emri se paku dy here. Unë i pata dy çështje të cilat i ngrita në kuvend. Për mu kjo është e papranueshme, sepse jemi të zgjedhur me vot të popullit dhe me i përfaqësu qytetarët e Komunës së Vitisë. Përgjigjen që unë morra prej nënkryetarit dhe drejtorit, unë mundem me pa se çfarë përgjegjësie kanë ata ndaj qytetarëve. Tek nënkryetari po nderlidhem, tek tema të cilën nënkryetari tha, dhe unë e kuptoj përgjegjen që ky e jep dhe mos njohur që i ki ti që ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve dhe që dhjetë vite të qeverisë. Kryetari i komunës nuk ka ditë asnjë politik të vetme me shty përpara, përveç që me shtru asfalt, dhe asfaltin që e ka shtru e ka shtru me vend e pa vend, me pranim e pa pranim teknik, e unë nuk pres prej kryetarit me mendu për këto familje që kanë gjendje të vështirë ekonomike, kur nuk keni qenë në gjendje për dhjetë vite me e ngritë çështjen e ujit të pijshëm. Sa i përket çerdheve, e ki kryetarin i cili në mandatin e tij i ka premtu katër çerdhe dhe sot del në kohë fushate, pa u skuqur fare lyp mbështetje të qytetarëve duke i mashtruar dhe duke bë premtime të pavend, të parealizuara. Dy çerdhe i ki në Komunën e Vitisë të cilat janë mundësu nga niveli qendror dhe e ki një kryetar i cili banë manipulim të opinionin publik dhe mundohet që ato dy investime ti paraqes si investime të tij.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Majlindë unë këto bindjen e tua të smuta politike, të cilat nuk e di ku e ki qëllimin, nuk e ki kurrë të drejtën me ba vlerësimin e një personaliteti, se sa po i dika a sa nuk po i dika. Harroe këtë, sepse atë vlerësim me fal që po flas për veti, se ne mesin e njerëzve që e kanë kry fakultetin kam qenë vetëm 23 vite, që në atë kohë nuk ka pas prej krejt provimeve të fakultetit, se dy, tre a katër provime ju kam nënshtru dy here, krej i kam të përfunduara me herën e parë. Prandaj, shumë po i qet vetes problem, por unë po të thamë korrigjov, se je e re, mos këshyr me e marr gjithçka fushatë para vete se jam e zgjedhur e popullit. Dhe

tjetra qe du me të thanë, plotë janë të zgjedhura të popullit, po po me shti me të thanë, mjerisht që të kanë zgjedh, se kurr kurgja nuk ki bë edhe nuk banë.

z.Nexhat Halili: Përgjigjen që e tha nënkryetari rreth trotuarit në Sllatinë – Trestenik, se kontrata ka përfunduar dhe nuk mund të vazhdohet. Është e vërtet se kontrata me 27.10.2023 ka përfundnu, po prej kësaj date është një vit, dhe gjatë kësaj periudhe punët nuk jan ndal, punët vazhdojnë. Ejani shihni trotuaret, e shehni që punët janë duke vazhdu. Pyetjen e kam: n'bazë cilës kontratë janë duke u ba punët, kur 50% kanë përfundu, po kanë mbetë për afërsisht ende pa përfundu. Në realitet nuk ka kontratë, e punët vazhdojnë.

z.Basri Sylejmani: Kryesues, nëse himë në çështje politike mundemi me fol tanë natën këtu. Unë jam në kontakt me drejtorin, e kanë pastru rrugën.

z.Jakup Demiri: Nenkryetari këtu ma dha një përgjigje. Të gjitha përgjigjet i dha sa me thanë diçka. E tek puna e konkurseve, konkurset na mirë e dimë se për shkak se aty përfiton nja e tani votat i hupin 100. Kjo është strategjia e cila funksionon këtu deri me 9 shkurt i anulon kryetari. Çka është kjo, a është kryetar apo mbret. Drejtor, sa për informatë, ja si i ki rrugët tash per momentin. Rruga e Beguncës, asnjë kamion nuk ka kalu aty. Nuk është pastru rruga, e ti asnjë rrugë nuk e ke kry. E kam cekë edhe tek vorret e dëshmorëve që ta kanë lanë aty, rruga që është dëmtu, kurrë nuk e ki rregullu. Drejtor, kjo kompania kurrë nuk e ka kry punën e paret i ka marrë. Sot prej Smirës menxi që jam ardh, e dje në Stubëll menxi që kemi shku. Nuk ka pas rrugë të pastrume në ora 10 të ditës e nuk po flas per natën. Na e dimë se si qëndron Komuna e Vitisë, si qeveriset. E keni Qendrën për Punë Sociale, asnjë psikolog nuk e keni, të gjithë janë jurista. Kryetari i komunës ka bë momerandum bashkëpunimi. Kryetari i komunës dy ditë para zgjedhjeve, 12.02.2021 me Ministrinë e Bujqësisë, për sistemin e ujitjes në Skifteraj, mandje pa kërku asnjë dokument, e ka akuzu të tjerët. **(Nuk dëgohet çka diskuton).**

z.Basri Aliu, drejtor: Sa i përket intervenimeve në rrugë për Smirë, nuk e përmenda, se kemi mendu që është e kalushme. Unë i përmenda me emra fshatrat të cilat i kemi pastru. Mirëmbajtja e rrugëve në Komunën e Vitisë. Nuk e ki asnjë qytet më mirë të mirëmbajtur se sa në Komunën e Vitisë. Ti e dinë, rrugën për Stubëll e ka ministria, po ne kemi shku prapë kemi intervenu, e kemi pastru edhe pse është rrugë që e pastron ministria.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Matrialin e keni marrë me kohë. Për këtë seancë kemi këtë rend dite:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbdhjet e kuvendit komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.
4. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
5. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Vitisë për vitin 2024.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim planit për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

A keni me diskutu për rendin e ditës? Nëse jo, unë e kam edhe nje pikë shtesë, nëse jeni dakort me hi në rend dite, tek **Rregullorja për ndryshim plotësim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba**. E kanë kërku ministria, edhe një ndryshim i cili u kërku. A jeni që të miratohet rendi i ditës me këtë pikë shtesë? Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës, pa asnjë kundër, asnjë abstenim.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbdhjet e Kuvendit Komunal

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Atëhere, me 21 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet procesverbalit.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025

Këtë listë e miratojmë çdo vit, e kemi obligim ligjor. A ka dikush me diskutu për këtë pikë të rendit të ditës?

z.Jakup Demiri: Këtu në komunën tonë nuk i interson me i shërby qytetarëve. Unë e kam analizu këtë listë me këto prona. Do janë kot fare, mirëpo do janë të ngarkume, kur e di që ka telashe, ka të interesuar, ka edhe takime ndërmjet njerëzve. Unë personalish ka me abstenu në këtë pikë, sepse këto prona nuk janë interes i qytetarëve.

z.Illir Zuka: Është shqetësuese se banorët nuk marrin pjesë në dëgjime publike, konkretisht e patëm tani për Hartat Zonale në Pozharan, që nuk pat të interesuar, po edhe në Smirë nuk ka pas të interesuar që kanë marrë pjesë në dëgjime.

z.Jakup Demiri: Ilir, mu dy orë pa fillu mbledhja me ka ardh mesazhi, mirëpo kur të ju duhen për diçka tjetër i njoftojnë, i thirri.

z.Bekim Azizi, kryesues: Lista për debatet publike është publiku në web të komunës që dy javë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Jakup, dëgjimin për Hartat Zonale e banë drejtoria së bashku me kompaninë. Unë e di që naj ka qu shkresën edhe neve në ekzekutiv, un e di që e kanë qitë edhe në web.

z.Sejdi Emini: Unë mendoj që njëri ndër asetet kryesore që komuna i ka janë pronat e saj që i ka nën mbikëqyrje të saj. Nuk e di unë cili qytetar nuk kish dash me i marr 20 - 30 hektar tokë për 20 - 30 vite në shfrytëzim, sepse atij i duhet tri gjenerata në perëndim me punu për me mujt me i bë 30 hektar tokë e me i shfrytëzu 30 vite. Edhe unë po quditem sa lehtë po flasim me dhanë pronat sa më shpejt ose e fundit qysh te muj me ja bë në Komunën e Vitisë, në qytet. Asnjë pllamë tokë nuk e kemi që mujm me shfrytëzu për interes të qytetarit. Po ato private që kushtojnë milionshe. Ama mos ta bajmë kaq lehtë me dhënë tokë, sepse përgjegjësinë e kemi na që jemi të zgjedhur këtu, e aq më shumë ekzekutivi për me i shqyrtu ato prona dhe me ju dhënë rëndësi. Në fillim të mandatit ka qenë dashur me i shqyrtu e me pa interesin e këtyre pronave, se qeshtu qysh ja kemi nis shpejt kemi me i hargju këto pak prona qe i kemi. Pse nuk i marrim ne dhe me i trajtu në mënyrë më të mirë të mundshme, edhe me thirrë investitor për prodhim, kush do qoftë, vendor e ndërkombëtar, se sa me ja dhanë dikujt pronën për 30 vite. Unë jam i sigurt se çfarë do kompanie e huaj vjen, sepse ka interes ta baj një politikë ndryshe.

z.Bekim Azizi, kryesues: A jeni që të miratohet kjo pikë e rendi të ditës? Me 15 vota pro, 3 abstenime, kundër nuk ka, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për dhënie e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë

Komisioni ka afat dyvjeçar. Ekzekutivi i ka propozu dy anëtarë, dy nga kuvendi dhe një nga shoqëria civile. Unë e propozoj Reshat Azizin, sepse nuk është pjesë e asnjë komisioni.

z.Jakup Demiri: Ne e propozojmë Sejdi Eminin.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Me 21 vota pro, zero kundër, zero abstenim, u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025

Komiteti për Komunitete, ju e dini që është komitet obligativ i kuvendit. Ne më herët e kemi miratu planin e punës së kuvendit dhe të KPF, ndërsa ky komitet e ka miratu këtë plan të punës. Në mbledhjen e tyre, para juve sot e kanë paraqitë këtë plan. A ka për diskutim? Pasi që nuk ka e qes në votim për miratim. Me 21 vota pro, zero kundër, zero abstenim u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Vitisë për vitin 2024

Znj. Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Raporti prezent pasyqron përmbledhjen e aktiviteteve të cilat ndimojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e integritetit të institucioneve komunale, e të cilat kanë qenë të përcaktuara me Planin e Integritetit për vitin 2024, si: hartimi dhe aprovimi i planit zhvillimor komunal, formimi i procedurave të prokurimit për zgjedhjen e operatorit ekonomik për hartimin e hartave zonale në Komunën e Vitisë, plani i personelit, e të tjera. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z. Bekim Azizi kryesues: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka, kalojmë në pikë tjetër.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim planit për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025

Znj. Ibadete Hyseni, zyrtare për barazi gjinore: Me këtë plan janë përcaktuar objektivat për vitin 2025, që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë publike. Materialin e keni marr me kohë. Për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z. Bekim Azizi, kryesus: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Musli Neziri: Faleminderit zyrtares për këtë informatë. Ndoshta me pyet këtu tek anëtarët e KKS-së, sa anëtar janë, a ka ndryshime apo është i njëjti që ka qenë?

z. Bekim Azizi, kryesus: KKS-në e miraton kuvendi, është në mandat të kuvendit. Nuk mundet me pas ndryshime pa ardh në kuvend. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim për miratim. Me 19 vota pro, zero kundër, zero abstenim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për ndryshim plotësim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba

Me kërkesën e ministrisë, qes në votim për miratim këtë ndryshim plotësim. A jeni që të bëhet ky ndryshim plotësim. Me votat e të gjithëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë! Shihemi në seancat e radhës!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Republika e Kosovë
Republika Kosova
Republic of Kosovo

| | | | |
|--|------------|------------------|-------------------|
| Pranuar - Prunjenio Me Data 15-01-2025 | | | |
| Nr. i Organi- Org. Broj | Numri Broj | Shtojca Datoj | Vlera Vrednost |
| 02 | 035 | 02 | 28 |

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 30, paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Kuvendit propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2025

Neni 1

Me këtë propozim Vendim, propozojmë që takimet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në vitin 2025, të mbahen si vijon:

| Muaji | Takimet e Kuvendit të Komunës (Data) | Takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa (Data) |
|---------|--------------------------------------|---|
| Janar | 30.01.2025 | 21.01.2025 |
| Shkurt | 28.02.2025 | 19.02.2025 |
| Mars | 28.03.2025 | 19.03.2025 |
| Prill | 30.04.2025 | 18.04.2025 |
| Maj | 29.05.2024 | 20.05.2025 |
| Qershor | 27.06.2025 | 18.06.2025 |
| Korrik | 31.07.2025 | 22.07.2025 |
| Gusht | Pushim | Pushim |
| Shtator | 30.09.2025 | 19.09.2025 |
| Tetor | 31.10.2025 | 22.10.2025 |
| Nëntor | 28.11.2025 | 29.11.2025 |
| Dhjetor | 29.12.2025 | 18.12.2025 |

Neni 2

Kuvendi sipas nevojës mbanë edhe mbledhje tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Neni 3

Seancat solemne të Kuvendit do të jenë, si në vijim :

- 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- 5 Maj - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë;
- 14 Qershor – Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa do të mbahen njëherë në muaj, gjegjësisht 7 (shtatë) ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës
P.S. Orari i mbledhjeve mund të ndryshoj për arsye të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË · OPSTINA VITINA

| | | | |
|---|--------------|-------------------|-------------------|
| Pranimi - Pranimi Me Dana... 10.01.2025 | | | |
| Nr. i origjantit Org. Broj | Nr. i Pro... | Viteq... E...q | Vlera Vrednost |
| 02-035/02- | | | 16 |



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 35 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferove me nr. 3346-1/2024, e datës 30.12.2024, nenin 50, shkronja i të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 08.01.2025 i propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta bënë plotësimin-ndryshimin e vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.

Neni 2

Bazuar në Kërkesën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferove me nr. 3346-1/2024, e datës 30.12.2024, plotësim-ndryshimi i vendimit të cekur në neni 1 të këtij propozim vendimit ka të bëjë tek preambula ku neni 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2, e datës 15 Shkurt 2018) fshihet dhe zëvendësohet dhe duhet të jetë neni 35 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Neni 3

Te gjitha pjesë tjera të vendimit Nr. 01-035/02-1356, të datës 29.11.2024, për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025 mbeten në fuqi.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haki



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Hija: Org. 04/Kom
 Nr. Prot. 3346-1/2024
 Dat. 30.12.2024
 PRISHTINE/A



HYRESE - ULAZNA - INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Data 30.12.2024
 Nr. Lendes -VI- 020-715/6

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

| | |
|----------------------|---|
| Për: | Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| Përmes: | Avni Zogiani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| Nga: | Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Datë: 26.12.2024 |
| Zyrtarët përgjegjës: | Referencë: 293/2024 1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor: Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor: Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. 3. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor: Vehap Hashani, Udhëheqës i Divizionit për çështje ligjore të tatimit në pronë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| Lënda: | Shqyrtim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Vitisë |
| Lloji i aktit: | Vendim |

I nderuari Kryetar z. Haliti,
I nderuari Kryesues z. Azizi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

| |
|---|
| <i>Vendim Nr. 01-035/02-1356 për caktimin e normave tatimore për tatimin e pronave të paluajtshme për vitin 2025.</i> |
| <i>I miratuar më datë 27.11.2024</i> |
| <i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 29.11.2024</i> |
| <i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 04.12.2024</i> |

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Vitisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vitisë, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon për caktimin e normave tatimore për tatimin e pronave të paluajtshme për vitin 2025.
2. Gjatë marrjes së këtij vendimi, Komunat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.
3. Vlen të theksohet, se me datë 12.12.2024 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, me efekt nga data 1 janar 2025, me ç'rast ka hyrë në fuqi neni 35, si në vijim:

Neni 35

Zbatimi i shkallës progresive të tatimit në pronën e paluajtshme.

Zbatimi i shkallës progresive për tatimin në pronën e paluajtshme sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-005, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-224, shtyhet dhe fillon së aplikuari nga viti-tatimor 2026. Për vitin tatimor 2025, vazhdon të aplikohet Shkalla Tatimore Tranzitore e paraparë sipas Nenit 39 /A të Ligjit Nr. 06/L-005, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-224.

4. Ky nen ka përcaktuar shtytjen e zbatimit të shkallës progresive të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin 2026. Si rrjedhojë e kësaj, për vitin tatimor 2025 do të vazhdojë të zbatohet norma tatimore për kategoritë e pronave bujqësore, pyjore, rezidenciale, komerciale

dhe industriale në shkallën tatimore që mund të variojë prej 0.1% deri 1%, ashtu siç është përcaktuar me nenin 39/A të Ligjit nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 39 /A

Shkalla tatimore tranzitore.

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin I të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

5. Marrë parasysh arsyet e përcaktuara më lartë, Ministria ka shqyrtuar vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Vitisë dhe konsideron se i njëjti është nxjerrë në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, respektivisht është nxjerrë sipas shkallës tatimore tranzitore të përcaktuar me nenin 39/A të Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme. Megjithatë, përkundër përcaktimit të normës së duhur tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025, komuna e Vitisë ka përdorur bazën e gabuar ligjore në përcaktimin e kësaj norme.
6. Andaj, mbi këto sqarime, Ministria evidenton se Akti i Komunës së Vitisë është nxjerrë brenda afatit ligjor dhe në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Mirëpo, Ministria rekomandon ndryshimin e bazës ligjore mbi të cilën është bazuar vendimi i tillë, respektivisht të riformulohet pjesa e preambulës nga: "neni 9 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme" dhe të zëvendësohet me formulimin "neni 35 i Ligjit Nr. 0/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025."

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vitisë, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

*** Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ***



| | | | |
|----------------------------|--------------|-----------------|--------------------|
| Emërimi i Datës 10.01.2025 | | | |
| Numri i Qyt. Bër. | Numri i Bër. | Adresë e Primit | Vlera e Vlerësimit |
| 02-035/02-15 | | | |

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit me nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 09.01.2025, bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1

Me këtë propozim – vendim propozohet të behet ndryshimin dhe plotësimin i vendimit paraprak me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së ineteresit, sipas kërkesës nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresë Nr.020-315/5, të datës 23.12.2024.

Neni 2

Propozohet të ndryshohet preambula e vendimit me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024 tek neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit me nr. 06/L-092, për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës ndryshohet-plotësohet dhe duhet të jetë neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit me nr. 06/L-092 , për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 3

Neni 3 i Vendimit me Nr.01-035/02-1358 të datës 29.11.2024, ndryshohet-plotësohet prona e palujtshme komunale ipet në shfrytëzim afatgjatë deri në 20 vite përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 4

Pjesët tjera të vendimit me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024, mbeten të pandryshuarar.

Neni 5

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:

Sokol Haliti





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

| | | |
|----------------------|---|-----------------------------------|
| Për: | Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Erblin Hetemi, Ud. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 04.12.2024 VI-020-715 |
| Zyrtaret përgjegjës: | Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim | |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të komunës së Vitisë | |

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraprak 01-035/02-1358 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

I miratuar më datë: 27.11.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 29.11.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës r nuk është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2024, ka miratuar Vendimin paraprak 01-035/02-1358 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

MAPL, konstaton së baza ligjore e vendimit konkretisht neni 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës sqarojnë dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër përmes procedurës së ankandit publik, ndërsa përmbajtja e vendimit është bazuar në dhënien në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së shprehjes së interesit. Po ashtu edhe neni 3 i vendimit i përket procedure te ankandit publik, procedurë e cila përcakton çmimin fillestar. Kuvendi i komunës së Vitisë duhet të specifikoj se përmes cilës procedurë do të ipet në shfrytëzim prona komunale.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Vitisë, duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|--------------|--------------------|-------------------|
| Pranuar - Priljetno Me Datën 29-M-2024 | | | |
| Nr. i Orgjani Org. Broj | Numri i Broj | Shtetësi Krahut | Vlera Vrednost |
| 01- | 035/02- | | 1358 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8, paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14 të Ligjit me Nr.06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2024 miraton këtë:

V E N D I M

Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës miraton vendim që të jepet pëlqimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik deri në 20 vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznese, respektivisht vendosjen e paneleve solare përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2

Prona e palujtshme për dhënien në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zhabelj, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 96342 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Çmimi fillestar i pronave të palujtshme komunale të cekura në nenin 2 pika 1 dhe 2 të këtij vendimi do ta përcaktoj komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim afati gjatë.

Neni 4

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është interesi publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 5

Procedurat për dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes shprehjes së interesit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra për Administratë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Vitisë.


Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadastër, Pronë;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Prilbjen Me Dana 1500/- - 2023 | | | |
|--|----------------|-------------------|-------------------|
| Nr. i Organizimit Org. Broj | Niveli Broj | Shtesa Prilbje | Vlera Vrednost |
| 01-560 | / | 01- | 29 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Janar 2025

Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë

Për: Kuvendin Komunal të Vitisë

Tema: Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, për periudhën Janar- Dhjetor 2024.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar edhe komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka realizuar po thuaja që 100% planin e punës se kuvendit për vitin 2024.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka mbajtur gjithsej -XII- mbledhje të rregullta, -IV- mbledhje solemne dhe -I- mbledhje të jashtëzakonshme

Kuvendi ka miratuar gjithsej 64 vendime, 1 rregullore, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat nga MAPL-ja.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka mbajtur -XII- mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur -XI- mbledhje.

Përveç këtyre komiteteve, kemi të themeluar edhe komitete të tjera, si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
4. Komiteti për Liritë të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë joobligative, nuk kanë qen aktiv, sepse me Ligjin e Pagave nuk po lejohet pagesa e mëditjes.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjenë më Dana 15-01-2025

| Nr. i Kartës Org. Breg | Nr. i Breg | Shtetja Prilbjet | Vlera Vrednost |
|---------------------------|----------------|---------------------|-------------------|
| <u>01-</u> | <u>016/01-</u> | | <u>32</u> |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Informatë mbi punën e Komitetit për komunitet të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Janar 2025

Nga: Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

Për: Kuvendin Komunal të Vitisë

Tema: Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2024

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar- Dhjetor 2024, i cili komitete është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë.

Komititet për Komunitete komunës së Vitisë është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv.

Komiteti për komunitetet e komunës së Vitisë për periudhën janar - dhjetor 2024 ka arritur një shkallë të lartë realizimi të planit të punës së komitetit, afërsisht 100% realizim të planit të punës për vitin 2024.

Komititet për Komunitete i komunës së Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024, ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta ku ka shqyrtuar tema të ndryshme dhe ka dalur me kërkesa konkrete dhe rekomandime për zyrën e kryetarit të komunës së Vitisë dhe drejtorive përkatëse komunale.

Numër i madh i rekomandimeve që janë miratuar në mbledhjet e Komitetit për Komunitete janë realizuar nga organet kompetente të komunës, besoj se do të realizohen edhe të tjerat gjatë këtij viti.

Komititet për Komunitete i komunës së Vitisë ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2025 të cilin plan është miratuar në Kuvendin Komunal të Vitisë

Me datën: 15.01.2025

**Kryesuesi i Komitetit
Srdjan Djuric**





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Priljeno Me Dana 10-12-2024 | | | |
|---------------------------------------|------------|---------------------|-------------------|
| Nr. i Organiut Org. Broj | Numri Broj | Shtepite Priljet | Vlera Vrednost |
| 02- | 016 | 01- | 1608 |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

INFORMATË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË KKSb-së PËR VITIN 2024

Viti, Dhjetor 2024

Bazuar në Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2024, ku kanë qenë të parapara një sërë objektiva dhe aktivitete për realizimin e këtyre objektivave, KKSB ka kryer këto aktivitete:

- Janë mbajtur 4 takime të KKSB-së, ku në këto takime përveç raportimit të rregullt të gjendjes së sigurisë në Komunë e Vitisë, nga Policia e Kosovës, janë shtjelluar tema të ndryshme rreth çështjes së sigurisë publike të qytetarëve.
- Në lokalitete të ndryshme të Komunës së Vitisë është rregulluar sinjalistika horizontale dhe vertikale në komunikacion
- Janë rregulluar trotuare në shumë zona të komunës
- Është rregulluar ndriqimi publik në disa zona të Komunës
- Policia e Kosovës, bazuar në Planin e KKSB-së dhe në planet e saja operationale ka kryer një sërë aktivitete të cilat janë realizuar në komunitet dhe me nxënës në shkolla e të cilat janë:

Organizimi i ligjëratëve në disa shkolla të Komunës së Vitisë me këto tema: Parandalimi i trafikimit me njerëz, Parandalimi i dhunës në familje, lajmet e rreme (Fake News), parandalimi i përdorimit të narkotikëve, keqpërdorimi i rrjeteve sociale (krimet kibernetike), ku këto aktivitete janë realizuar edhe nga QPS, dhe psikologë shkollorë

- Janë formuar ekipet e nxënësve për siguri në shkolla, të cilat do të identifikojnë problemet e nxënësve që cenojnë sigurinë e nxënësve në shkollë dhe do të propozojnë masa për parandalimin dhe luftimin e tyre
- Është funksionalizuar Këshilli Komunal për Parandalimin e Dukurive Negative nga të rinjtë, i cili këshill është duke hartuar propozim masa të reja në parandalimin e këtyre dukurive
- Komuna në bashkëpunim me forumet e sigurisë siç janë Policia dhe EVSB ka shënuar javën për të drejtat e viktimave të krimit, ku janë shpërndarë posterë me moton “ Thyeje heshtjen, raporto viktimat e krimit”
- Komuna e Vitisë, ka shpallur vitin 2024 vit të mbrojtjes së pyjeve, ku në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe sektorin e pyjeve janë vendosur pikat statike për kontrollimin e pyjeve në mënyrë të pengimit të dëmtimit të pyjeve nga persona të papërgjegjshëm si dhe ka shpërndarë posterë me mesazhe për mbrojtjen e pyjeve
- Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë patrullimin e rrugëve frekuentive me nxënës të shkollave si dhe gjatë orarit të vajtes së tyre në shkollë dhe anasjelltas

- Mbajtja e takimeve të rregullta ndër institucionale dhe ndër komunale : KKSB-EVSB-KLSB, të tjerë
- Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarve policor për konceptin e policimit në bashkësi
- Policia e Kosovës përmes planeve operative dhe të vazhdueshme ka ushtruar kontrollë të trafikut rrugor për të zvogluar aksidentet
- Zyra për Riatdhesim ka ofruar vazhdimisht shërbime dhe udhëzime për personat e riatdhesuar
- Policia e Kosovës në vazhdimësi ka zbatuar Planin operativ për siguri në shkolla, ku rregullisht ka monitoruar sigurinë në shkolla
- Policia e Kosovës ka bërë rregullisht patrullimin e rrugëve gjatë fushatës së korrje shirjeve përgjatë muajit Korrik
- Policia e Kosovës ka bërë patrullimin e rregullt në trafik gjatë qëndrimit të mërgimëtarve në vendlindjet e tyre (përgjatë muajit Korrik – Gusht)
- Me datë 18 Tetor është bërë hapja e fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore me moton “ Mos Hesh”, ku për gjatë këtij muaji janë mbajtur aktivitete të shumta me nxënës në shkollat e mesme të larta si dhe në ato të mesme të ulëta
- Me datë 25 Nëntor është bërë hapja e fushatës për parandalimin e dhunës në familje me moton “ Sot dhe çdo ditë tjetër” e cila është shënuar me aktivitete të shumta në shkolla dhe komunitet dhe janë shpërndarë posterë me mesazhe sensibilizuese për parandalim dhe raportim të rasteve viktime të dhunës si dhe me datë 10 dhjetor është bërë mbyllja e kësaj fushate me aktivitete të shumta në shkolla në shënim të ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut 10 Dhjetorit.
- Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me Njesia e sektorit dhe komunitetit në Polici, në vazhdimësi ka mbajtur takime me drejtorë të shkollave të komunës së Vitise dhe njëkohësisht me këshillin e prindërve në bashkërendim të aktivitetëve të ndryshme në luftimin e dukurive negative në shkolla.

Dhjetor 2024, Viti

